



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Raport përmbledhës: Statistikat e Mjedisit

Anketa e Mbeturinave të Trajtuara
2023

Nëntor, 2024

Përmbledhje e Statistikave të Mjedisit

Raporti ofron informata rreth sasisë dhe trajtimit të mbeturinave në Kosovë gjatë vitit 2023, duke përfshirë të dhëna mbi mbeturinat e ricikluara, sterilizuara dhe të deponuara. Ai përmban informacion mbi përqindjet e mbeturinave të trajtuara sipas llojit të mbeturinave dhe llojit të trajtimit, duke theksuar riciklimin e materialeve si plastika, metali, letra dhe kartoni, si dhe sterilizimin e mbeturinave medicinale.

Gjithashtu, raporti analizon ndryshimet krahasuese me vitin 2022, duke evidentuar një rënie të lehtë të sasisë së mbeturinave të deponuara dhe thekson sasinë më të madhe të mbeturinave të deponuara në regjionin e Prishtinës. Ky raport pasqyron përpjekjet për menaxhimin e mbeturinave dhe sfidat që mbeten në drejtim të riciklimit dhe deponimit të qëndrueshëm.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara (AMT) për vitin referues 2023, si pjesë e një ankete vjetore të rregullt. Qëllimi i këtij hulumtimi është të sigurohen të dhëna të qëndrueshme statistikore për sektorin e mbeturinave në Kosovë. Rezultatet e paraqitura në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikore mbi gjendjen aktuale të këtij sektori.

Rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara

Tabela e mëposhtme ofron informacion mbi sasinë e mbeturinave të trajtuara në vitin 2023, të cilat janë ndarë sipas llojit të mbeturinave dhe llojit të trajtimit (deponim, riciklim dhe sterilizim).


Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 1, në vitin 2023, gjithsej sasia e mbeturinave të ricikluara ka arritur në 25,736 ton, ndërsa sasia e mbeturinave të sterilizuara (mbeturina medicinale) ka qenë 2,540 ton. Po ashtu, sasia totale e mbeturinave të trajtuara dhe të deponuara në vitin 2023 ishte 518,592 ton. Krahasuar me të dhënat e vitit 2022, vërehet një rënie e lehtë prej -0.5%.

Tab. 1: Mbeturinat e trajtuara sipas llojit në vitin 2023/t

Mbeturina	Deponuara	Ricikluara	Sterilizuara	Gjithsej
Mbeturina spitalore			2 540	2 540
Mbeturina të letres dhe kartonit		16 869		16 869
Mbeturina nga metali		4 646		4 646
Mbeturina nga plastika dhe		4 221		4 221
Mbeturina nga ekonomitë familjare dhe të ngjashme	490 316			490 316
Gjithsej	490 316	25 736	2 540	518 592

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në vitin 2023, sasia e mbeturinave të trajtuara, e ndarë sipas llojit të mbeturinave dhe llojit të trajtimit (të ricikluara dhe sterilizuara), e shprehur në përqindje si më poshtë: 14.9% e mbeturinave nga plastika janë ricikluar, 16.4% e mbeturinave nga metalet janë trajtuar në mënyrë të ngjashme, ndërsa 9.0% e mbeturinave medicinale (spitalore) janë sterilizuar. Mbeturinat nga letra dhe kartoni përbëjnë pjesën më të madhe, me 59.7% të mbeturinave që janë ricikluar.



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Sipas të dhënave në tabelën 2, në vitin 2023, gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara ka arritur në 490,316 ton, duke shënuar një rënie të lehtë prej -1.4% krahasuar me vitin 2022. Në nivel rajonal, sasia më e madhe e mbeturinave të deponuara është regjistruar në deponinë sanitare të regjionit të Prishtinës (Mirash), me 176,986 ton ose 36.1% të gjithsej sasisë të mbeturinave të deponuara.

Tab. 2: Të dhënat e mbeturinave të deponuara në deponit e licencuara në vitin 2023/t

Deponitë	Gjithsej /ton	%
DS-Podujevë	17 239	3.5
ST-Ferizaj	24 066	4.9
DS-Gjilan	43 720	8.9
DS-Mitrovicë	53 855	11.0
DS-Pejë	56 986	11.6
DS-Prizren	117 464	24.0
DS-Prishtinë	176 986	36.1
Gjithsej	490 316	100

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Oda Ekonomike e Kosovës

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: info@oek-kcc.org

Web: www.oek-kcc.org